



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1408/2 prot.

Datë 04.06.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Climacasa” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF- 02682-04-25-2024, me objekt: “Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe impianteve hidrikë për shuarjen e zjarrit”, me fond limit 25,858,120.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike Tiranë.
- Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Oni”SHPK & “Cara” SHPK, përfaqësuar nga operatori ekonomik “Oni” me NIPT J66902008N dhe adresë: Lagjia Vasil Shanto, Rruga Hydajet Lezha, Nr 32, Shkodër.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike Tiranë.
Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Climacasa” SHPK. me NIPT L07805502F dhe adresë: , Rruga "Shtraus", Pallati Nr. 1, kati perdhe, Njesia me numer pronesisë 5/82-N1, ZK Nr. 863, Lezhë.

Në datën 03.06.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4149, si dhe nr. protokollit 1408/2024 datë 03.06.2024, i operatorit ekonomik “Oni” SHPK, përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Oni”SHPK & “Cara” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF- 02682-04-25-2024, me objekt: “Shërbime për

riparimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe impianteve hidrikë për shuarjen e zjarrit”, me fond limit 25,858,120.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Climacasa” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime**”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriteret e kualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimes “Oni” SHPK, përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Oni”SHPK & “Cara” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatorit ekonomik “Climacasa” SHPK pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Konkretisht:

- I. Operatori ekonomik “Climacasa” SHPK nuk plotëson kriteret për kualifikim si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

2.3.2 Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre specialistët e domosdoshëm për të realizuar objektin e këtij prokurimi si mëposhtë minimumi:

6 (gjashtë) punonjës, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën minimumi Janar 2024 - Mars 2024:

1 (një) inxhinier mekanik,

1 (një) inxhinier elektronik,

1 (një) punonjës mekanik, i kualifikuar, i pajisur me diplomë të shkollës së meseme profesionale mekanike.

1 (një) punonjës elektrikist, të jetë i pajisur edhe me dëshmi kualifikimi nga organizëm i akredituar në Shqipëri.

1 (një) punonjës hidraulik, të jetë i pajisur edhe me dëshmi kualifikimi nga organizëm i akredituar në Shqipëri.

1 (një) punonjës ekspert zjarrfikës i pajisur me nje dokument provues te vlefshem.

Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë “Dokumentin e Vlerësimit të Riskut (DVR)”, në pajtim me Ligjin Nr.10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shendetin në Punë”, i ndryshuar, sipas fushes së objektit të veprimtarisë. (në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, mjafton disponueshmëria e 1 DVR për të gjithë BOE)

(Kriteret 2.3.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.)

Shënim: Një punonjës mund të ketë më shumë sesa një kualifikim/ trajnim nga ato të kërkuara më sipër.

2.1.2 Përsa i përket aftësisë teknike dhe profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të vendosura nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

a. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikaten ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësive, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. (dokumentacioni të paraqitet në gjuhën shqipe ose i perkthyer dhe e noterizuar).

b. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me ISO 14001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. (dokumentacioni të paraqitet në gjuhën shqipe ose i perkthyer dhe e noterizuar).

Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që Certifikatat ISO janë të leshuara nga një entetifikues i njohur nga Drejtoria e Akreditimit Shqiptar. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike certifikatat janë të detyrueshme për të gjithë operatorët sipas llojit dhe sasisë së shërbimeve.

(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes)

Operatori ekonomik ankimes ngre pretendimin se oferta e operatorit ekonomik “Climacasa” SHPK është anomalisht e ulët.

Po ashtu, operatori ekonomik ankimes pretendon se KVO dhe autoriteti kontraktor duhet të vlerësojnë ofertat sipas përcaktimit të konceptit të marrëveshjes kuadër dhe sipas faktit duke vlerësuar të gjitha ofertat në bazë të ofertave totale në raport me fodin limit total.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 04.06.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri